VENDIM
Nr. 684, datë 2.9.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 433, DATË 8.6.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKIVE TË PYJEVE DHE KULLOTAVE PUBLIKE, SIPAS LISTAVE TË INVENTARIT, DHE AKTUALISHT NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË MJEDISIT E TË ISH-KOMUNAVE/BASHKIVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18, të ligjit nr. 48/2016, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005, 'Për pyjet dhe shërbimin pyjor', të ndryshuar", dhe të nenit 9, të ligjit nr. 49/2016, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007, 'Për fondin kullosor', të ndryshuar", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 9, numri rendor "… 2 236 (dy mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) ..." zëvendësohet me "... 2 262 (dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy) …".

b) Në pikën 13, numri rendor "… 31 (tridhjetë e një) ..." zëvendësohet me "... 26 (njëzet e gjashtë) …".

c) Në pikën 14, numri rendor "… 711 (shtatëqind e njëmbëdhjetë) ..." zëvendësohet me "... 666 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) …".

ç) Në pikën 15, numri rendor "… 3 283 (tre mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre) ..." zëvendësohet me "... 3 298 (tre mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë) …".

d) Në pikën 16, numri rendor "… 186 (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë) ..." zëvendësohet me "... 281 (dyqind e tetëdhjetë e një) …".

dh) Në pikën 17, numri rendor "… 97 (nëntëdhjetë e shtatë) ..." zëvendësohet me "... 114 (njëqind e katërmbëdhjetë) …".

e) Në pikën 19, numri rendor "… 3 433 (tre mijë e katërqind e tridhjetë e tre) ..." zëvendësohet me "... 3 553 (tre mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre) …".

ë) Në pikën 20, numri rendor "… 1 534 (një mijë e pesëqind e tridhjetë e katër) ..." zëvendësohet me "... 1 554 (një mijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër) …".

f) Në pikën 21, numri rendor "… 1 009 (një mijë e nëntë) ..." zëvendësohet me "... 1 028 (një mijë e njëzet e tetë) …".

g) Në pikën 23, numri rendor "… 27 (njëzet e shtatë) ..." zëvendësohet me "... 42 (dyzet e dy) …".

gj) Në pikën 24, numri rendor "… 26 (njëzet e gjashtë) ..." zëvendësohet me "... 24 (njëzet e katër) …".

h) Në pikën 25, numri rendor "… 55 (pesëdhjetë e pesë) ..." zëvendësohet me "... 58 (pesëdhjetë e tetë) …".

i) Në pikën 26, numri rendor "… 52 (pesëdhjetë e dy) ..." zëvendësohet me "... 41 (dyzet e një) …".

j) Në pikën 27, numri rendor "… 638 (gjashtëqind e tridhjetë e tetë) ..." zëvendësohet me "... 569 (pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) …".

k) Në pikën 41, numri rendor "… 3 152 (tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) ..." zëvendësohet me "... 3 075 (tre mijë e shtatëdhjetë e pesë) …".

l) Në pikën 42, numri rendor "… 1 242 (një mijë e dyqind e dyzet e dy) ..." zëvendësohet me "... 1 209 (një mijë e dyqind e nëntë) …".

ll) Në pikën 43, numri rendor "… 2 792 (dy mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy) ..." zëvendësohet me "... 2 803 (dy mijë e tetëqind e tre) …".

m) Në pikën 44, numri rendor "… 1 093 (një mijë e nëntëdhjetë e tre) ..." zëvendësohet me "... 973 (nëntëqind e shtatëdhjetë e tre) …".

n) Në pikën 45, numri rendor "… 4 672 (katër mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) ..." zëvendësohet me "... 4 559 (katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë) …".

nj) Në pikën 46, numri rendor "… 722 (shtatëqind e njëzet e dy) ..." zëvendësohet me "... 663 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre) …".

o) Në pikën 47, numri rendor "… 3 216 (tre mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) ..." zëvendësohet me "... 3 303 (tre mijë e treqind e tre) …".

p) Në pikën 48, numri rendor "… 2 160 (dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) ..." zëvendësohet me "... 2 299 (dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) …".

q) Në pikën 49, numri rendor "… 1 340 (një mijë e treqind e dyzet) ..." zëvendësohet me "... 1 460 (një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) …".

r) Në pikën 51, numri rendor "… 3 571 (tre mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një) ..." zëvendësohet me "... 4 031 (katër mijë e tridhjetë e një) …".

rr) Në pikën 53, numri rendor "… 3 (tre) ..." zëvendësohet me "... 7 (shtatë) …".

s) Në pikën 57, numri rendor "… 500 (pesëqind) ..." zëvendësohet me "... 485 (katërqind e tetëdhjetë e pesë) …".

sh) Në pikën 59, numri rendor "… 19 (nëntëmbëdhjetë) …" zëvendësohet me "… 29 (njëzet e nëntë) …".

t) Në pikën 60, numri rendor "… 125 (njëqind e njëzet e pesë) ..." zëvendësohet me "... 146 (njëqind e dyzet e gjashtë) …".

th) Në pikën 62, numri rendor "… 351 (treqind e pesëdhjetë e një) ..." zëvendësohet me "... 416 (katërqind e gjashtëmbëdhjetë) …".

u) Në pikën 63, numri rendor "… 244 (dyqind e dyzet e katër) ..." zëvendësohet me "... 278 (dyqind e shtatëdhjetë e tetë) …".

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shtojcat sipas pikave 9, 13, 14, 15, 16, 17, 19, 20, 21, 23, 24, 25, 26, 27, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 51, 53, 57, 59, 60, 62, 63 zëvendësohen me shtojcat me të njëjtin numër, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Pas pikës 68 shtohen pikat 68/1 dhe 68/2, më këtë përmbajtje:

"68/1. Në rastet kur për parcelat pyjore/kullosore ka mospërputhje midis koordinatave digjitale me ato të terrenit, për pasuritë që ndodhen në zonat e mbrojtura, pasuritë të regjistrohen në ASHK vetëm pasi të merret dakordësia nga institucioni përgjegjës për administrimin e zonave e mbrojtura.

68/2. Sipërfaqet e transferuara në pronësi të bashkive, të cilat janë pjesë e fondit pyjor e kullosor publik, të përcaktuara për t'u përdorur për kompensim fizik, bazuar në vendimin nr. 1077, datë 18.6.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi pyjor dhe kullosor", nuk janë objekt i kalimit në pronësi, dhënies me qira apo i kontraktimit me të tretët nga bashkitë përkatëse. Këto sipërfaqe mbeten në dispozicion të Agjencisë së Trajtimit të Pronave për kompensim fizik.".

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, bashkitë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe